



HIGJIENA SH.A.	
03/Bordi	290
04/9	15 04 2022

Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena", Sh.A.Deçan
Rregullore e funksionimit të Bordit të Drejtorëve

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT TË DREJTORËVE TË N.P.L" HIGJIENA" SH.A-DEÇAN

Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, mbështetur në Ligjet mbi plotësim-ndryshimet e disa dispozitave të të njëjtit, bazuar në Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare nr.06/L-016, bazuar në Statutin e Ndërmarrjes, e lidhur me punën e Bordit të Drejtorëve, me qëllim të sigurimit të kushteve për kryerjen normale të aktiviteteve dhe funksionit të punës së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrje Publike Lokale në këtë periudhë, Bordi në mbledhjen e vet të rregullt me nr 1, të mbajtur me datë: 15/04/2022, aprovoi këtë rregullore siç vijon:

RREGULLORE

Për funksionimin e punës dhe sigurimin e kushteve optimale për anëtarët e Bordit të Drejtorëve

Neni 1

Parimet themelore

- 1.1. Zbatimi i kësaj Rregulloreje nga ana e Drejtorëve është unike për të gjithë Drejtorët Jo ekzekutiv të N.P.L-së.
- 1.2. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve është përgjegjës të mbikqyrë drejtpërdrejtë zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.
- 1.3. Drejtorët e Bordit duhet të udhëhiqen nga parimet e paanshmërisë, profesionalizmit, objektivitetit, barazisë, konfidencialitetit dhe transparencës së brendshme, gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre.

Neni 2

Qëllimi

- 2.1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të krijohen kushte optimale në funksionim të punës, të sigurojë një presence dhe afërsi më të madhe të Bordit të Drejtorëve me Zyrtarët e Ndërmarrjes si dhe funksionimin e zakonshëm të aktivitetit të Drejtorëve që janë anëtarë të Bordit të Drejtorëve në ushtrimin e detyrave përfshirë këtu edhe punën e Komisioneve të Përkohshme.

Neni 3

Fushëveprimi

Kjo Rregullore iu referohet të gjithë Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Neni 4

Mbledhja e Bordit/ marrja e vendimeve

- 4.1. Mbledhjen e Bordit e udhëheq Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me Ligjin dhe Statutin e N.P.L”Higjiena”. Kryesuesi e përcakton kuorumin për mbajtjen e takimit, e drejton debatin, e përcakton si dhe deklaron rezultatet e votimit.Kryesuesi i Bordit, në rast të mungesës së Sekretarit do të mban vet Procesverbalin ose do të autorizon ndonjë prej Drejtorëve të Bordit ose personin tjetër për mbajtje të procesverbalit.
- 4.2.Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve përbëhen në mënyrë valide me prezencën e shumicës së Drejtorëve/ Anëtarëve të Bordit dhe duhet të veprojnë me votën pohuese/ aprovuese të shumicës së Drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 4.3.Drejtorët të cilët abstenojnë nga votimi dhe Drejtorët që kanë shpalosur konflikt interesi nuk do të përfshihen në numërimin në lidhje me shumicën.Në rast të barazimit me vota, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të ketë votën vendimtare.
- 4.4.Nëse për shkak të boshllëkut, numri i Drejtorëve është më i vogël se numri i vendosur si kuorum, Drejtorët e mbetur(apo Drejtori) mund të veprojnë vetëm për qëllim të thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme për plotësimin e vendeve të lira.
- 4.5.Mbledhja e Bordit të Drejtorëve mundet të mbahet në më shumë se një lokacion, me lidhje të dyanshme përmes zërit apo video-konferencës, përderisa kërkesat e parashtruara janë përmbushur dhe arsyetuar në procesverbal, udhëheqësi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përcaktoj identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë prezent në mbledhje, do të udhëheq mbledhjen dhe do të konstatojë dhe deklaron rezultatet e votimit.

Neni 5

Përfaqësimi i N.P.L” Higjiena”, Sh.A në Deçan nga Bordi i Drejtorëve

- 5.1.Me qëllim të sigurimit të funksionimit normal të Ndërmarrjes dhe në rastet e caktuara kur tregohet e arsyeshme dhe ekonomikisht e justifikueshme, Bordi mund të vendosë që anëtarët e Bordit të organizojnë udhëtime brenda dhe jashtë vendit, në organizime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si përfaqësues të Ndërmarrjes.Procedura e miratimit të udhëtimeve zyrtare dhe përcaktimi i anëtarëve të cilët do të udhëtojnë, bëhet sipas vendimit të Kryesuesit.Gjatë udhëtimeve zyrtare, anëtarët e Bordit duhet që të përmbahen dhe të veprojnë në kuadër të autorizimeve të veta, duke mos interferuar me përfaqësimin e Ndërmarrjes, që është i rezervuar ekskluzivisht për Kryeshefin Ekzekutiv.
- 5.2. Drejtorët e Bordit kanë të drejtë në shpenzime të reprezentacionit me lejen dhe aprovimin paraprak të Kryesuesit të Bordit.
- 5.3. Për destinacionin e paraparë në pikën 1, Ndërmarrja do të dedikojë një buxhet të caktuar në buxhetin e vitit vijues, në qendrën e shpenzimeve të zyrës së KE-së. Për periudhën fillestare, do të shfrytëzohen mjetet ekzistuese buxhetore nga zyra e KE-së.

5.4. Në të gjitha rastet kur takimet apo organizimet e ngjajshme zyrtare mbahen në _____(vendi) apo në ndërtesën e Ndërmarrjes Publike "Higjiena", Sh.A në Deçan, shpenzimet ditore mbulohen nga buxheti i Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes.

5.5. Të gjitha shpenzimet të cilat janë krijuar nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Anëtarët e Bordit të Drejtorëve si në nenin 4, pika 1 dhe pika 2, ose shpenzimet tjera të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve me rezoluta të posaqme, vërtetohen, verifikohen dhe aprovohen nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe si të tilla duhet të ekzekutohen nga Departamenti i Financave të Ndërmarrjes Publike "Higjiena", Sh.A në Deçan.

5.6. Të gjitha shpenzimet e Bordit, të përshkruara në pikën 1.2. dhe të përmendura në pikën 5 të nenit 4, i nënshtrohen dispozitave të Rregulloreve Interne të Ndërmarrjes mbi pagesën e udhëtimeve zyrtare, dhe duhet të jenë në harmoni me Ligjin në fuqi për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Auditimit.

Neni 6

Kryerja e Aktiviteteve

6.1. Me kërkesë të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes "Higjiena", Sh.A në Deçan, anëtarëve të Bordit, iu lejohet që për nevoja të kryerjes së detyrave zyrtare, të ju sigurohen pajisjet siç vijon;

- 6.1.1. Pajisje teknike për përdorim zyrtar (Një kompjuter apo Laptop)
- 6.1.2. Një telefon fiks, eventualisht mobil, për përdorim zyrtar.
- 6.1.3. Angazhimi i vozitësve në vajtje-ardhje për nevojat e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, për takime zyrtare apo kompenzimin e shpenzimeve vajtje-ardhje në takime sipas rregullave dhe politikave interne.

6.2. Me qëllim të funksionalizimit të raportit ndërmjet Drejtorëve dhe Menaxhmentit Ekzekutiv, do të caktohet një punonjës/e në cilësinë e asistentit/es i cili ose e cila do të kryejë punë administrative/ përkthime në zyrën e KE, në kordinim me Sekretarin.

6.3. Zyra e Financave obligohen që të sigurojnë një nën- llogari në zyrën e KE-së, dhe të kujdesen që këto shpenzime të krijuara nga anëtarët e Bordit të regjistrohen në këtë nën-llogari.

6.4. Të gjitha pajisjet, siç parashihen në pikën 1, do të mbeten në pronësi të Ndërmarrjes dhe do të menaxhohen sipas dispozitave të Rregulloreve Interne të Ndërmarrjes për pajisjet e IT-së, përdorimin e automjeteve zyrtare dhe përdorimin e telefonave zyrtar.

Neni 7

Përgjegjësitë e Drejtorëve të Bordit të Ndërmarrjes "Higjiena", Sh.A.Deçan.

7.1. Drejtorët e Bordit të N.P.L "Higjiena" janë përgjegjës për përdorimin e aseteve dhe pajisjeve zyrtare të Ndërmarrjes sipas ligjit dhe në interes të Ndërmarrjes.

7.2. Për qdo shmangie apo keqpërdorim të pajisjeve zyrtare, nga ana e Drejtorëve të Bordit, ata do të përgjigjen sipas Ligjit në fuqi, ndërsa Kryesuesi i Bordit duhet të ndërpresë çdo veprim të tillë dhe menjëherë ta njoftojë me shkrim aksionarin e NPL-së, për një sjellje të tillë.

Neni 8

Ndryshimi, Plotësimi dhe Interpretimi

8.1. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Rregulloreje është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike ose ndonjë Ligj të zbatueshëm në Republikën e Kosovës, ajo dispozitë do të konsiderohet e pavlefshme dhe e pa efektshme.

8.2. Me iniciimin e Kryesuesit të Bordit , apo së paku të dy Drejtorëve, kjo Rregullore mund të ndryshohet, plotësohet apo të zëvendësohet me ndonjë Rregullore tjetër.

8.3. Dispozitat e paqarta të kësaj Rregulloreje interpretohen me kërkesë të Bordit të Drejtorëve nga Menaxhmenti Legal i Ndërmarrjes.

8.4. Bordi mund të saktësojë dhe sqarojë dispozitat e kësaj Rregulloreje, ose të përcaktojë të drejtat dhe autorizimet plotësuese, me vendime të veçanta.

Neni 9

Zbatimi

Kryeshefi Ekzekutiv do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme , me qëllim të zbatimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje, jo më larg se 30 ditë, nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore u shqyrtua dhe u miratua në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të N.P.L' Higjiëna', Sh.A në Deçan, të mbajtur me datë: 15/04/2022 dhe ka efekt veprimi nga data e aprovimit.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

z.

Milazim Hashtkala

